



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3239/5 prot.

Datë 05.01.2024

V E N D I M
Nr. 01/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh, me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 28.12.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Classic” SHPK me NIPT: J91909004J, me adresë: AUTOSTRADA TIRANË -. DURRËS KM 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: ALBPETROL SH.A me adresë: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 28.12.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

II.2. Në datë 12.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “AUTO FRANCE - AL” SHPK, mori vendimin Nr. 1288/2023, datë 12.12.2023, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AUTO FRANCE - AL” SHPK për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha modifikimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “AUTO FRANCE - AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.3. Me shkresën nr. 10324 prot., datë 18.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2753/8 prot., datë 20.12.2023, autoriteti kontraktor ALBPETROL SH.A, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

II.4. Në datën 18.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit me objekt “Shtojcë në dokumentet standarde të tenderit me objekt “Marrje automjete me qira” me REF- 85607-10-27-2023”.

II.5. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentet e tenderit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, ndaj me vendimin nr. 1344/2023 datë 21.12.2023 vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Në datën 28.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa protokolluar me nr. 3239/2023 protokollit, e operatorit ekonomik “Classic” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e shtojcës së publikuar nga autoriteti kontraktor në datë 18.12.2023 për modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.6.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 41/2 prot., datë 04.01.2023, të ardhur në postën elektronike zyrtare të komisionit të Prokurimit Publik protokolluar me tonën me nr. 3239/2 prot., datë 04.01.2023 me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Classic” SHPK për Dokumentet Standarde të Tenderit të procedurës së prokurimit me objekt “Marrje automjetet me qira” me numër reference REF- 85607-10-27-2023”, konstatohet se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 30.10.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

III.2. Në datë 12.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “AUTO FRANCE - AL” SHPK, mori vendimin Nr. 1288/2023, datë 12.12.2023, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AUTO FRANCE - AL” SHPK për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha modifikimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “AUTO FRANCE - AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.3. Me shkresën nr. 10324 prot., datë 18.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2753/8 prot., datë 20.12.2023, autoriteti kontraktor ALBPETROL SH.A, informon se ka zbatuar vendimin e

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “*Marrje automjete me qira*”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

III.4. Në datën 18.12.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit me objekt “*Shtojcë në dokumentet standarde të tenderit me objekt “Marrje automjete me qira” me REF- 85607-10-27-2023*”.

III.5. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentet e tenderit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1282/2023, datë 12.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, ndaj me vendimin nr. **1344/2023** datë 21.12.2023 vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “*Marrje automjete me qira*”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 29.11.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.6. Në datën 28.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa protokolluar me nr. 3239/2023 protokollin e operatorit ekonomik “Classic” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e shtojcës së publikuar nga autoriteti kontraktor në datë 18.12.2023 për modifikimin e dokumenteve të tenderit.

III.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.6.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 41/2 prot., datë 04.01.2023, të ardhur në postën elektronike zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 3239/2 prot., datë 04.01.2023, me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Classic” SHPK për Dokumentet Standarde të Tenderit të procedurës së prokurimit me objekt “Marrje automjetet me qira’ me numër reference REF- 85607-10-27-2023”, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III.6.3. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.*

III.6.4. Neni 30 pika 1 “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.6.5. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.6.6. Në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, *“Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

Neni 115, *“Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës”.*

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimin të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.*

III.6.7 Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar është 10 ditë, nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret rezulton, se më datë 18.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit.

Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Classic” SHPK, referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se është paraqitur pranë këtij të fundit më datë 28.12.2023, si dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 28.12.2023, jashtë afateve ligjore të ankimimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 1 e LPP, i cili parashikon se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të tenderit 18.12.2023 dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, data e publikimit të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është 18.12.2023, ndërkohë për ankesën e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor është data 28.12.2023, jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Afati i ankimit për ankimuesin, në rastin konkret fillon në datën 18.12.2023, ditë në të cilën ankimuesi është njohur me dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Classic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh, me kursin e këmbimit të datës 26.10.2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 28.12.2023 nga autoriteti kontraktor, ALBPETROL SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Classic” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

